

FTESE PER OFERTE**Ndërtim Portali, Mirëmbajtje dhe Menaxhim, Data entry****Projekti: “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”**

Instituti e Studimeve Politike (ISP), do të implementojë projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit(KSHH) organizatë lider si dhe në partneritet me BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare(QQ).Ky projekt mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike.

Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, ISP hap thirrjen për angazhimin e një subjekti /eksperti/të informatikës që përfshin ndërtimin e portalit të dedikuar për këtë projekt, mirëmbajtjen, update-in.

Subjekti/Eksperti, bazuar në kërkesat dhe të dhënat e vendosura në dispozicion nga stafi zbatues i ISP, duhet të përmbushë shërbimet e mëposhtme:

- Të krijojë seksione te reja, ndërtojë, mirëmbajë dhe përditësojë portalin në funksion të projektit dhe backup të vazhdueshëm të të dhënave;
- Të mbështesë të gjithë ciklin jetësor të ueb-it në internet për gjithë kohëzgjatjen e projektit (duke përfshirë konceptin, testimin, publikimin, ngarkimin e materialeve, ofrimin e mbështetjes teknike);
- Të lidhet rregullisht me koordinatorin e projektit/skuadrën e projektit dhe marr pjesë në takime kur është e nevojshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit;
- Të kontribuojë në planifikimin dhe sugjerimin e veçorive/zgjidhjeve të reja;
- Të sigurojë përputhjen e produktit me legjislacionin në fuqi për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave;
- Të kujdeset për reflektimin e materialeve të nevojshme pjesë e seksioneve të ueb-site dhe t’ju kthejë përgjigje përdoruesve në kërkesat e tyre;
- Të adresojë drejt subjektit IT të kontraktuar, çdo keq-funksionim apo crash teknologjik që mund të pësojë ueb- site;

ISP inkurajon aplikimet nga subjektet dhe kandidatët, të cilët janë të interesuar për t’u angazhuar në këtë proces që plotësojnë kriteret në vijim:

Procesi i përzgjedhjes

Përzgjedhja e aplikantit/subjektit më të favorshëm do të jetë e brendshme dhe vendimi do të merret nga një komision vlerësimi prej 3 anëtarësh.

Aplikantët mund të paraqesin çdo pyetje shtesë dhe/ose kërkesë për sqarime në formë elektronike në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com.

Subjektet/ekspertët e interesuar janë të lutur të japin ofertat e tyre që të dërgojnë deri në datën 24.01.2023, ora 12.00 në formë elektronike në adresën e e-mailit të ISP contactaips@gmail.com, me postë ose dorazi me zarf të mbyllur me mbishkrim sipër zarfit: "Ofertë për web" në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

Ftohen ato subjekte/eksperte IT të interesuara që përmbushin kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

- Të jenë të regjistruara pranë QKB –për subjekte
- Te jenë fleksibël deri në variantin final dhe të ofrojë garanci për dorëzimin e materialit brenda afatit dhe sipas specifikave teknike.
- Çmimi të përfshijë dhe TVSH -në.
- Faturat pranohet vetëm të fiskalizuara.
- Preferohen subjekte të licencuara me objekt veprimtarie në përputhje me shërbimet e kësaj kërkesë për ofertë
- Preferohen subjekte që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tiranë

Dokumentacioni i kërkuar:

- Nipt te subjektit (për subjektet)
- Curriculum Vitae (për expert IT)
- Ofertë financiare me firmë dhe vulë në GBP duke përfshirë një ndarje buxheti, sipas kategorive

Periodha e angazhimit është 12 muaj, kurse fondi limit është 3000 GBP për të gjithë periudhën e angazhimit.

Lutemi specifikoni qartë adresën e subjektit, e-mail ose një nr. kontakti. Vetëm subjekti i përzgjedhur do të lajmërohet pas procedurës së përzgjedhjes.

Sinqerisht,
Instituti i Studimeve Politike